


PËRGJEGJËSIA I TAKON POPULLIT NË ZHVILLIMIN E DEMOKRACISË



NDËRTHURJA E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE

ALBAN (15), ERBLIN (15), NESTRETE (14), AGNESA (15), ARJANITA (14), ERDONITA (15), NURIE (15)



Në demokraci, ndërthuren të drejtat dhe detyrimet. Për ta kuptuar si ndodh kjo, lexojeni këtë artikull që përmban intervista me mysafiret tona nga Kuvendi i Shqipërisë

Sot ishte ditë e veçantë për ne. U bëmë gazetarë për herë të parë, këtu në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“. Ndërsa, në grup të vogël diskutuam pikërisht për demokracinë. Ajo çka e bëri edhe më të veçantë këtë ditë, ishte fakti se në grupin tonë kishim dy mysafire shumë të këndshme nga Shqipëria.

Znj. Mimoza Tasi dhe znj. Kledia Haska, ishin mysafire të grupit tonë, të cilat u përgjigjen në pyetjet tona. Mimoza Tasi, e cila është Drejtoreshë e Shërbimit të Seancës Plenare, na ka treguar rëndësinë që ka demokracia në jetën tonë si qytetarë. Sipas zonjës Tasi, demokracia është sistem, ku populli ushtron në nivel më të lartë të drejtat e veta. Ajo përmendi edhe disa nga të drejtat tona, që janë: e drejta e jetesës, e drejta e të ushqyerit, e drejta e lëvizjes, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta shkollimit, e shumë të drejta të tjera. Nuk duhet harruar se ne si qytetarë kemi edhe përgjegjësi apo detyrime ndaj vendit tonë. „Të drejtat dhe detyrimet duhet të ndërthuren për të çuar përpara nevojat shoqërore dhe vendin tonë“, ka thënë zonja Hasi. Mysafirja jonë e dytë znj. Kledia Haska, e cila është Këshilltare e Partisë Socialiste, na ka përshkruar një ditë të zakonshme të sajën. Dita për të, fillon sikur për të gjithë ne të tjerët. Në mëngjes, ajo përgatit ag-

jendën për 65 deputetë si dhe 14 ministra. Dita e enjte, është dita e saj më e ngarkuar, meqë mbahet seanca plenare. Ajo luan një rol të rëndësishëm dhe është shumë afër përfaqësuesve të popullit, të cilët punojnë në Kuvend. Sot, e kuptuam se demokracia ka vlerë të madhe në jetën e të gjithë neve. Këtë e kuptuam gjatë diskutimit në grup të vogël, por edhe gjatë përgjigjeve që i morëm nga mysafiret tona.


Duhet përmendur se elementet e demokracisë janë: solidariteti, toleranca, respekti, liria, paqja, etj. Pikërisht ne jetojmë në bazë të këtyre elementeve. Marrim shembull, kur klasa jonë ka fituar vendin e parë në gara të volejbollit. Shpërblimin e marrë, ia kemi dhuruar një familjeje me nevoja të veçanta. Pra, jemi solidarizuar me ta. Ky është një shembull shumë i mirë i solidaritetit në demokraci. Ne, ju ftojmë që edhe ju të veproni njësoj. Demokracia na mundëson të jetojmë të lumtur. Prandaj, ta respektojmë atë.



Autorët e artikullit së bashku me mysafiret

VOTA JUAJ, ARDHMËRIA JUAJ

FATLINDA (15), ERBLINA (15), ARTIONA (15), ERION (15), LEONARD (16), VALMIR (15)



Të dashur lexues, për t'i kuptuar më mirë zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre, sot kemi zhvilluar një intervistë me znj. Estela Kondura, Sekretare e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë. Ju ftojmë ta lexoni këtë artikull

Sot për grupin tonë ishte një ditë më ndryshe se të tjerat. Kjo për arsye se sot kemi ardhur këtu në Punëtoritë e Demokracisë, për të mësuar më shumë për demokracinë, duke mos harruar edhe temat e tjera.

Grupi ynë shtjelloi një temë shumë të rëndësishme, pra është fjala për zgjedhjet. Lidhur me këtë temë, realizuam edhe një intervistë me mysafiren tonë.

Pyetja e parë që ne ia parashtruam znj. Kondura ishte: Çka janë zgjedhjet? Sipas saj: „zgjedhjet janë mendim i çdo qytetari, për të zgjedhur një kandidat ose një forcë politike për t'i përfaqësuar dhe plotësuar nevojat tona“. Pra, kjo nënkupton se çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtë të marrë pjesë në dy lloje të zgjedhjeve: në zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Në zgjedhjet lokale, qytetarët votojnë për asamblenë komunale dhe kryetarin e komunës, ndërsa në zgjedhjet qendrore, qytetarët votojnë për partitë politike dhe deputetët që janë në kuadër të partive të ndryshme politike, ka shtuar znj. Kondura.

Në pyetjen se cila prej këtyre zgjedhjeve është më e rëndësishme, znj. Kondura u përgjigj: „Të dyja janë të rëndësishme, p.sh. në fshatin Banjë, nëse rruga Skënderbeu është dëmtuar, duhet t'i drejtohem Asamblesë Komonale. Ndërsa, një shembull konkret për zgjedhjet qendrore kemi mungesën e barnave dhe kushtet jo

të mira shëndetësore. Ky mund të jetë një problem i madh i banorëve, të cilët kërkojnë zgjidhje për këtë situatë. Për këtë duhet t'i drejtohen Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo është arsyeja se pse një qytetar duhet të dalë të votojë, sepse vota e secilit ka vlerë shumë të madhe dhe përmbush nevojat dhe kërkesat tona“.

Ajo gjithashtu tregoi se „nëse ne nuk dalim në zgjedhje, nuk kemi të drejtë të kërkojmë përgjegjësi nga udhëheqësit komunal dhe ata qendror. Për këtë, secili qytetar duhet të zgjedh atë që është në nivel të lartë të arsimit, që është i afërt me qytetarët, që ka program të mirë dhe që i përmbush nevojat e tij/saj“.


Vota është pushtet i çdo qytetari, andaj voto.



Foto e zhvilluar gjatë intervistës me të ftuarën tonë



Kuvendi i Kosovës nuk bën dallime, sepse është institucion demokratik



Demokracia është sistem që e fuqizon vlerën e popullit dhe i përkrah mendimet e ndryshme



Të mësosh për demokracinë, do të thotë të kuptosh se çka do të thotë të jetosh i lirë



Bashkëpunimi, toleranca, respekti, janë vetëm disa nga parimet demokratike që ne i zbatojmë



Deputetët e Kuvendit të Kosovës mendojnë për të ardhmen tonë, prandaj ne do t'i respektojmë të gjitha ligjet



Ne kemi disa alternativa se ku të vazhdojmë shkollimin tonë, sepse demokracia na jep mundësi për të zgjedhur

INSTITUCION I PAQES DHE BASHKËPUNIMIT

GENTIAN (15), ARBNOR (15), RILIND (15), DORENTINA (15), LAURETA (15), QENDRESA (14),

MIGENA (15)



Lexues të nderuar, a e dini se cili është institucioni i paqes dhe i bashkëpunimit në Kosovë?

Ky institucion është Kuvendi, i cili merr vendime shumë të rëndësishme për jetën tonë. Në Kuvend diskutohen çështje të ndryshme që i ndikojnë jetërat e qytetarëve. Më poshtë, do të njoftoheni më shumë se çfarë rëndësie ka Kuvendi për ne. Siç e dini, populli ka fuqi shumë të madhe, dhe këtë fuqi e transferon tek deputetët, të cilët janë përfaqësuesit e popullit. Për të qenë përfaqësues i popullit, duhet të zotërohen disa tipare dhe kriteret. Informatat se cilat janë tiparet kryesore dhe kriteret që duhet t'i përmbushin kandidatët për deputetë i kemi marrë nga zotëri Gazmend Bici i cili është Këshilltar Ligjor në Parlamentin e Shqipërisë. Sipas mendimit të tij: „tiparet kryesore të kandidatëve për deputetë janë ndershmëria dhe përkushtimi. Me këtë, kuptojmë se deputetët duhet t'i zotërojnë këto

tipare që ta udhëheqin shtetin në mënyrën më të mirë të mundshme“.

Z. Bici tha: “disa nga kriteret që kandidatët për deputetë duhet t'i kenë janë: të jenë shtetas të atij vendi që kanë kandiduar për deputetë, të kenë arritur moshën 18 vjeçare, të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor për kryerjen e ndonjë veprë penale, të ketë zotësi juridike për të vepruar, etj“.

Pasi që kandidatët për deputetë marrin votat nga populli, ata bëhen deputetë dhe flasin në emër të popullit në Kuvend. Kështu ndodh edhe në shtetin tonë Kosovën. Kuvendi ynë ka disa funksione: funksionin përfaqësues, funksionin kontrollues dhe atë legjislativ. Kuvendi, po ashtu ka fuqi të zgjedh Qeverinë dhe Presidentin e vendit. Siç po e shihni miq të dashur, Kuvendi mendon për të ardhmen tonë, prandaj zbatoni edhe ju ligjet e marra nga Kuvendi. Të bashkuar bëjmë ndryshime, bëhu edhe ti pjesë e ndryshimit.



Duke diskutuar me mysafirin tonë për rolin e deputetëve në Kuvend



Ne jemi autorët e këtij artikulli, shpresojmë se keni mësuar më shumë për rolin e Kuvendit në jetën tonë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Naim Frashëri“
Klasa: IX-1
Vendi: Banjë, Malishevë